

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8332
E mërkurë, 1 korrik 2026
Çmimi 0.50 €

Sir Geoffrey Nice: Gjykata Speciale pasqyron objektiva të fshehta politike



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SERWER: JAM PENDUAR QË KAM MBËSHTETUR KRIJIMIN E DHOMAVE TË SPECIALIZUARA



Profesori amerikan, Daniel Serwer, ka folur për procesin gjyqësor në Hagë ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ai u shpreh se është penduar që kishte

mbështetur krijimin e Dhomave të Specializuara, duke vlerësuar se mbajtja në paraburgim e katër ish-krerëve të UÇK-së, si para fillimit të gjyqësorit ashtu edhe gjatë zhvillimit të tij për një

periudhë të gjatë, është e pajustificueshme. Serwer përmendi edhe ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, për të cilin tha se nuk ka pasur autoritet komandues mbi UÇK-në

KURTI E HAXHIU: BE-ja DUHET T'I PËRGJIGJET VULLNETIT TË KOSOVËS PËR ANËTARËSIM



GLPS-ja PARALAJMËRON RREZIK PËR HUMBJE FINANCIARE NGA PLANI I RITJES, PËRMENDEN 90.6 MILIONË EURO TË RREZIKUARA



AKTUALE



BE-ja NIS PËRGATITJET FINANCIARE PËR ANËTARËSIMIN E MALIT TË ZI

FRONTEX: RUSËT, KINEZËT DHE TURQIT KEQPËRDORIN REGJIMIN PA VIZA TË BALLKANIT PERËNDIMOR

SHSKUK-ja IA VAZHDON MANDATIN ELVIR AZITIT SI DREJTOR I PËRGJITHSHËM

EKONOMI



RRITET NUMRI I BIZNESEVE TË REJA NË KOSOVË

BQK-ja DORËZON NË KUVEND RAPORTIN VJETOR 2025

SPORT



FFK-ja NIS HARTIMIN E STRATEGJISË SË RE TË ZHVILLIMIT, PAS REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE NË KOHË REKORD

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja NIS PËRGATITJET FINANCIARE PËR ANËTARËSIMIN E MALIT TË ZI

BRUKSEL, 30 QERSHOR - Komisioni Evropian miratoi një paketë financiare për Malin e Zi, me vlerë prej gati 3.2 miliardë eurosh. Së bashku me vendimin për nisjen e hartimit të Traktatit të Anëtarësimit, ky konsiderohet një nga vendimet më të rëndësishme për Malin e Zi në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, pasi përfaqëson përgatitje konkrete financiare për anëtarësimin në bllok.

“Paketa e sotme është një tjetër hap konkret drejt së ardhmes së Malit të Zi në Unionin tonë. Po përgatisim Malin e Zi, shtetet anëtare dhe institucionet tona, sepse zgjerimi ka sukses vetëm kur është një projekt i përbashkët evropian, i ndërtuar mbi merita, përkushtim dhe besim”, tha presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen.

Komisionerja evropiane për Zgjerim, Marta Kos, tha se kjo paketë përfaqëson përbashkjen e angazhimeve të Bashkimit Evropian, ndërsa Mali i Zi vazhdon zbatimin e reformave në rrugën drejt anëtarësimit. “Kjo do ta bëjë kalimin e Malit të Zi nga një vend kandidat në një shtet anëtar sa më të lehtë që është e mundur. Do të sigurojë vazhdimësi që nga dita e parë e anëtarësimit”, tha Kos.

Sipas Komisionit Evropian, qëllimi i paketës është ta përgatisë Malin e Zi për pjesëmarrje të plotë në buxhetin dhe politikën e Bashkimit Evropian.

Kjo nënkupton se, menjëherë pas anëtarësimit, Mali i Zi do të mund të përfitojë nga fondet evropiane njësoj si shtetet e tjera anëtare, ndërsa, në të njëjtën



kohë, do të nisë të kontribuojë në buxhetin e përbashkët të BE-së. Në këtë mënyrë synohet të shmangen ndërprerjet në financim dhe të lehtësohet kalimi administrativ nga statusi i vendit kandidat në atë të shtetit anëtar.

Paketa bazohet në supozimin se Mali i Zi do të bëhet anëtar i BE-së në vitin 2028

Paketa financiare është hartuar mbi bazën e propozimit për buxhetin e ri shtatëvjeçar të Bashkimit Evropian për periudhën 2028-2034.

Llogaritjet janë bërë duke u nisur nga supozimi se Mali i Zi do të anëtarësohet në BE në vitin 2028. Paketa është pjesë e negociatave në kuadër të Kapitullit 33, që ka të bëjë me dispozitat financiare dhe buxhetore dhe përcakton mënyrën se si një shtet i ri anëtar merr pjesë në buxhetin e Bashkimit Evropian.

Në këtë dokument, Komisioni Evropian vlerëson se sa fonde do të mund të përfitonte Mali i Zi nga programet e ndryshme të BE-së, sa do të kontribuonte në buxhetin e përbashkët dhe cili do të ishte efekti i përgjithshëm financiar i anëtarësimit të tij.

Propozimi i është dërguar Këshillit të Bashkimit Evropian dhe do të shërbejë si bazë për negociatat me Malin e Zi në kuadër të Kapitullit 33.

Qëllimi i Komisionit është të sigurojë një kalim sa më të lehtë financiar, nëse Mali i Zi bëhet anëtar i BE-së në vitin 2028, duke kufizuar njëkohësisht ndikimin në buxhetet e shteteve ekzistuese anëtare.

Për këtë arsye, në qarqet diplomatike thuhet jozyrtarisht se anëtarësimi i Malit të Zi do t'u kushtonte qytetarëve të Bashkimit Evropian më pak se një euro në vit për kokë banori.

Mali i Zi: Dy vendime të rëndësishme nga BE-ja

Për Qeverinë e Malit të Zi, ky është një nga dy vendimet më të rëndësishme që Bashkimi Evropian ka marrë deri më tani në favor të këtij vendi. “Mali i Zi është i vetmi vend kandidat i përfshirë në këtë parashikim buxhetor - çka përbën një sinjal të fortë politik se Bashkimi Evropian e sheh atë si anëtarin e ardhshëm”, tha për Radion Evropa e Lirë ministrja

për Çështje Evropiane e Malit të Zi, Maida Gorçeviq.

Sipas saj, BE-ja po i planifikon qysh tani fondet që Mali i Zi do të mund t'i përdorë si shtet anëtar, në mënyrë që kalimi nga fondet e para-anëtarësimit te fondet e rregullta evropiane, të bëhet sa më lehtë dhe pa ndërprerje në financimin e projekteve zhvillimore dhe reformuese. “Ky planifikim tregon se Bashkimi Evropian nuk po përgatitet vetëm për vazhdimin e negociatave me Malin e Zi, por edhe për anëtarësimin e tij të suksesshëm, duke njohur rezultatet konkrete të reformave që po zbaton kjo qeveri dhe përparimin që vendi ka arritur në procesin e integritit evropian”, tha Gorçeviq.

Anëtarësimi i Malit të Zi në BE do të kishte kosto minimale

Sipas njohësve të procesit të integritit evropian, paketa financiare tregon se anëtarësimi i Malit të Zi në Bashkimin Evropian do të kishte një kosto shumë të vogël për qytetarët e BE-së. “Kjo paketë tregon qartë se sa e vogël është kostoja për Bashkimin Evropian nga anëtarësimi jo vetëm i Malit të Zi, por edhe i vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor. Nga ana tjetër, përparimi i shpejtë dhe i suksesshëm i Malit të Zi do të dëshmonte se Bashkimi Evropian, pavarësisht skepticizmit dhe vështirësive me të cilat përballlet, ende mund ta ringjallë politikën e zgjerimit”, tha për Radion Evropa e Lirë Peter Zherjaviç, korrespondent nga Brukseli për gazetën sllovene,

Delo.

Duke kujtuar zgjerimin e madh të Bashkimit Evropian në vitin 2004, kur në një ditë u anëtarësuan dhjetë shtete, Zherjaviç vlerësoi se hyrja e Malit të Zi në BE mund të nxisë zhvillimin ekonomik të vendit, falë fondeve të konsiderueshme që do të vihen në dispozicion nga buxheti evropian. “Anëtarësimi i Malit të Zi në Bashkimin Evropian do të kontribuonte edhe në forcimin e pozitës së tij si pjesë e hapësirës politike dhe të sigurisë së Perëndimit”, tha ai.

Si do të shpërndahen fondet?

Sipas propozimit të Komisionit Evropian për buxhetin e ri të BE-së, Mali i Zi mund të përfitojë gjatë periudhës shtatëvjeçare disa fonde evropiane: 1.99 miliardë euro përmes Planit Kombëtar dhe Rajonal të Partneritetit; 277 milionë euro nga Politika e Përbashkët Bujqësore; 592 milionë euro për programe në fushën e punëve të brendshme; 37 milionë euro për programet e bashkëpunimit ndërkufitar Interreg; si dhe fonde shtesë nga programe të tjera të brendshme dhe të jashtme të Bashkimit Evropian.

Mali i Zi është vendi më i avancuar kandidat në procesin e integritit evropian dhe konsiderohet si kandidati më i mundshëm për t'u bërë anëtar i ardhshëm i BE-së.

Deri tani, ai ka mbyllur përkohësisht 16 nga 33 kapitujt e negociatave.

Autoritetet në Podgoricë presin që negociatat e anëtarësimit të përfundojnë deri në fund të këtij viti, duke krijuar kushtet që Mali i Zi të bëhet anëtar i 28-të i Bashkimit Evropian gjatë vitit 2028.

VAPA REKORDE VË NË PROVË GATISHMËRINË E GJERMANISË

BERLIN, 30 QERSHOR - Thirrjet për masa më të forta mbrojtëse nga temperaturat ekstreme janë bërë më të zëshme në Gjermani, pasi fundjava me vapë rekorde ka shkaktuar probleme në spitale dhe shtëpi të kujdesit, ka dëmtuar infrastrukturën rrugore dhe ka penguar qarkullimin hekurudhor.

Qeveria federale tha se përgjegjësia për përballimin e situatës u takon landeve dhe autoriteteve lokale, por Katharina Droge, kryetare e grupit parlamentar të Partisë së Gjelbër në Bundestag, akuzoi Qeverinë e kancelarit Friedrich



Merz se nuk ka ndërmarrë masa për t'i mbrojtur qytetarët nga i nxehti ekstrem. “Friedrich Merz mund ta injorojë vapën nga kancelaria me ajër të kondicionuar, por infermierët

në spitale nuk munden”, tha Droge për transmetuesin publik ARD. “Ata punojnë në temperatura përvëluese, ndërsa të moshuarit në shtëpitë e kujdesit vuajnë,

sepse nuk ka ajër të kondicionuar. Prandaj, kemi kërkuar që të ndërmerren masa urgjente”, tha ajo.

Pasi temperaturat në lindje të Gjermanisë arritën rekordin prej 41.7 gradësh Celsius, Droge kërkoi që spitalet, shtëpitë e kujdesit, çerdhet dhe shkollat të pajisen sa më shpejt me sisteme të ajrit të kondicionuar.

Ajo propozoi gjithashtu subvencionimin e pajisjeve të ajrit të kondicionuar që funksionojnë me energji nga panelet diellore.

“Në verë, panelet diellore prodhojnë aq shumë energji

elektrike të lirë, sa që përdorimi i ajrit të kondicionuar në kombinim me to është plotësisht i realizueshëm”, tha ajo.

Droge kërkoi edhe mbjelljen e më shumë pemëve dhe shkurreve në qytete, duke theksuar se një pemë mund të ketë efekt ftohës sa disa pajisje të ajrit të kondicionuar.

Sipas saj, valët rekorde të të nxehtit tashmë janë bërë realitet dhe Gjermania duhet të përshtatet me pasojat e ndryshimeve klimatike. “Nëse nuk veprojmë tani për mbrojtjen e klimës, pas 20 vjetësh do t'i kujtojmë këto vera si të freskëta”, tha ajo.

SIR GEOFFREY NICE: GJYKATA SPECIALE PASQYRON OBJEKTIVA TË FSHEHTA POLITIKE

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Sir Geoffrey Nice, një nga juristët më me nam britanik, që ka shërbyer edhe si ish-prokuror i diktatorit serb Slobodan Milosheviq, pranë Tribunalit të Hagës për krime lufte, këto ditë ka vizituar Prishtinën ku mori pjesë në konferencën "Urat e Kujtimit", organizuar nga KIPRED dhe organizata "Liria ka emër".

Në një shkrim të botuar në fletushkën online të konferencës, Sir Geoffrey shpalos kujtimet e tija rreth gjykatës, duke rikujtuar një polemikë me juristë, ku avokati britanik thotë se Specialja është krijuar kryekëput nga presioni i vazhdueshëm nga BE dhe SHBA. Sipas Nice: "në një ndërhyrje të mëvonshme lidhur me Dhomat e Specializuara të Kosovës (KSC), korrigoja një folës që kishte pohuar se kjo gjykatë ishte themeluar si rezultat i një vendimi sovran të Kuvendit të Kosovës. I rikujtova të pranishmëve se përfaqësuesit e zgjedhur të Kosovës, në realitet, u detyruan ta pranonin këtë gjykatë nën presion të vazhdueshëm nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara".

Britanezi, i cili për një kohë shërbeu edhe si këshilltar i Qeverisë së Kosovës përgjatë procesit të themelimit të Dhomave të Specializuara, sjell dëshmi për veprimet unilaterale të BE-së në draftimin e statutit fillestar: "si pjesë e ekipit negociues të Kosovës, kam qenë dëshmitar i

drejtpërdrejtë se Statuti i Dhomave të Specializuara nuk ishte, në asnjë kuptim domethënës, rezultat i një marrëveshjeje me Kosovën. Sapo negociatorët evropianë u përballën me kundërshtime thelbësore nga pala kosovare ndaj draft-statutit, diskutimet praktikisht u ndërpre. Ajo që pasoi, sipas përvojës sime, ishte imponimi politik i një statuti të hartuar paraprakisht, i formësuar ekskluzivisht nga aktorët e BE-së dhe SHBA-së". Nice vlerëson se "Kosova nuk pati zë real në miratimin e tij, megjithatë ishte Kosova ajo që pagoi çmimin e këtyre veprimeve të imponuara, pa asnjë siguri se proceset do të sjellin përfundimisht drejtësi apo do të krijojnë bazë për pajtim".

Më tutje, Nice shpreh brengat se gjykata ka objektiva të fshehta politike: "Edhe më parë kam paralajmëruar publikisht se mënyra se si u krijua kjo gjykatë, duke filluar nga raporti i Marty-t e tutje, dukej se pasqyrore objektiva të fshehta politike".

Sipas Nice, "ka qenë e vështirë të përcaktohen me saktësi këto objektiva, por Serbia dukej qartazi shteti që kishte më së shumti gjasa të përfitonte nga një gjykatë e imponuar në mënyrën se si u imponuan Dhomat e Specializuara, të përqendruara vetëm te një etni për luftën e viteve 1998-1999". Duke iu referuar gjykimit të Thaçit, juristi që tashmë gëzon edhe titullin prestigjioz "Sir", të dhuruar nga Mbretëresha



Elizabetë, pajtohet me qëndrimet se aktakuza Prokurorisë kundër Thaçit dhe të tjerëve pasqyron një narrativë të përqendruar te interesat e Serbisë. Nice elaboron argumentet që ka dëgjuar dhe krahasimet midis Tribunalit të mëhershëm të Hagës dhe Dhomave të Specializuara: "Nuk kam pasur arsye të ndjek akuzat e ngritura

në çështjen kundër Thaçit dhe të tjerëve, dhe nuk e kam bërë këtë. Në konferencë dëgjova argumente se aktakuza e Prokurorisë kundër Thaçit dhe të tjerëve pasqyron një narrativë të përqendruar te Serbia dhe se karakterizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) si një strukturë ushtarake e organizuar e angazhuar në një Ndërmarrje

të Përbashkët Kriminale (Joint Criminal Enterprise) nuk mbështetet nga aktgjykimet e mëparshme të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (ICTY). Asgjë nga kujtesa ime mbi provat e paraqitura gjatë gjykimit të Millosheviqit, e as zhvillimet e mëvonshme, nuk më sugjeron se këto argumente janë të pasakta".

GJYKIMI NË HAGË, SERWER: JAM PENDUAR QË KAM MBËSHTETUR KRIJIMIN E DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Profesori amerikan, Daniel Serwer në një intervistë për "Ekonomia Online" ka folur lidhur me procesin gjyqësor në Hagë ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ai u shpreh se është penduar që ka mbështetur krijimin e Dhomave të Specializuara, pasi që sipas tij mbajtja në paraburgim e katërshes së UÇK-së, si para fillimit të gjykimit ashtu edhe gjatë procesit gjyqësor për kohë të gjatë është e pajustificuar.

Ai përmendi ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, për të cilin tha se nuk ka pasur autoritet komandues mbi UÇK-në. "Sigurisht që nuk e kam idenë se çfarë vendimi do të marrin. Ajo që do të thosha është se pendohem që e kam mbështetur krijimin e këtyre Dhomave të Specializuara, sepse mendoj se paraburgimi i gjatë, si para fillimit të gjykimit ashtu edhe gjatë procesit gjyqësor, ka qenë i pajustificuar sipas mendimit tim.

Nuk di ndonjë rrethanë që do ta justifikonte këtë, por nuk jam jurist dhe do të më duhet të pranoj çfarëdo vendimi që ata të marrin. Ndjenja ime e fortë, veçanërisht sa i përket Hashim Thaçit, sepse e njoh atë dhe e njoh më mirë rolin e tij sesa të të tjerëve, është se ai nuk ka pasur autoritet komandues mbi UÇK-në. Prandaj, mbajtja e tij përgjegjës mbi këtë bazë do të ishte një gabim i rëndë", ka theksuar Serwer.

I pyetur nëse pret lirin e tyre, Serwer u përgjigj shkurt. "Nuk pres asgjë", ka thënë ai. Por, shtoi se duhet të respektohet çfarëdo vendimi që merr gjykata. "Mendoj se duhet të respektohet çfarëdo vendimi që merr gjykata, por kjo nuk e ndryshon pikëpamjen time nëse një dënim është i justifikuar apo jo. Të tjerët nuk i njoh mirë, por Hashimin e njoh dhe e kam takuar menjëherë pas luftës. E pyeta për rolin e tij në UÇK dhe e di se ai rol nuk përfshinte autoritet komandues", u shpreh Serwer.





FRONTEX: RUSËT, KINEZËT DHE TURQIT KEQPËRDORIN REGJIMIN PA VIZA TË BALLKANIT PERËNDIMOR

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Shtetasit e Kinës, Rusisë dhe Turqisë hyjnë në vendet e Ballkanit Perëndimor pa viza dhe më pas përpiqen të vazhdojnë udhëtimin drejt Bashkimit Evropian, paralajmëron Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare, Frontex, në vlerësimin e fundit të rrezikut.

Brukseli, në të njëjtën kohë, u kërkon vendeve të rajonit të ashpërsojnë politikën e vizave dhe të mbyllin hapësirat që mundësojnë keqpërdorime të tilla.

Policia Kufitare e Bosnje dhe Hercegovinës konfirmon për Radion Evropa e Lirë se merr rregullisht informacione nga Frontex-i për migrimin e paligjshëm, kontrabandën e njerëzve dhe keqpërdorimin e mundshëm të regjimit pa viza. Ajo thotë se është në dijeni edhe për përpjekjet e shtetasve të huaj për të vazhduar në mënyrë të paligjshme udhëtimin drejt vendeve të Bashkimit Evropian. “Këto informacione nuk kanë të bëjnë vetëm me shtetasit e Federatës Ruse, Republikës Popullore të Kinës dhe Turqisë, por edhe me shtetas të vendeve të tjera”, thekson Policia Kufitare e Bosnje dhe Hercegovinës, duke shtuar se ajo bashkëpunon vazhdimisht me Frontex-in dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë.

Viteve të fundit, shumë shtetas

kinezë kanë mbërritur në Ballkan me avion dhe më pas janë përpjekur të vazhdojnë rrugën drejt BE-së.

Disa shtetas rusë, përfshirë edhe çeçenë, e kanë shfrytëzuar Ballkanin si rrugë transiti ose si strehim të përkohshëm, pas fillimit të luftës në Ukrainë, më 2022.

Frontex: Keqpërdorimet do të vazhdojnë

Në vlerësimin vjetor të rrezikut për periudhën 2026-2027, të publikuar në qershor, Frontex paralajmëron se lëvizjet migratore në Ballkanin Perëndimor do të vazhdojnë të pasqyrojnë zhvillimet në rrugën e Mesdheut Lindor.

Sipas agjencisë, shtetas të disa vendeve do të vazhdojnë të shfrytëzojnë regjimin pa viza në vendet e rajonit për të tentuar më pas hyrjen në Bashkimin Evropian.

Frontex veçon në këtë kategori shtetasit e Kinës, Rusisë dhe Turqisë, si dhe “poseduesit e pasaportave jordaneze me origjinë palestineze”.

Sipas agjencisë, presioni migrator mund të zbutet nga aksionet policore, faktorët sezonalë dhe efekti parandalues i dhunës dhe rrëmbimeve të kryera nga rrjetet e kontrabandës së njerëzve.

Megjithatë, ajo paralajmëron se

keqpërdorimi i regjimit pa viza do të vazhdojë.

Në të njëjtin raport thuhet se politikën e pavendosura në mënyrë të harmonizuar për vizat në vendet e Ballkanit Perëndimor, vazhdojnë ta lehtësojnë përdorimin e fluturimeve drejt rajonit si pikënisje për hyrje të parregullt në Bashkimin Evropian.

Frontex shton se korridori i Ballkanit Perëndimor, që kalon përmes Serbisë, Bosnje dhe Hercegovinës dhe Kroacisë drejt Sllovenisë dhe Austrisë, do të mbetet rruga kryesore për migrantët që vijnë nga rruga e Mesdheut Lindor.

Agjencia nuk iu përgjigj kërkesës së Radios Evropa e Lirë për koment lidhur me paralajmërimet për keqpërdorimin e mundshëm të regjimit pa viza në Ballkanin Perëndimor.

Komisioni Evropian prej vitësh kërkon harmonizimin e politikave të vizave

Komisioni Evropian u bën vazhdimisht thirrje vendeve të Ballkanit Perëndimor që t'i harmonizojnë politikën e tyre të vizave me rregullat e Bashkimit Evropian, me qëllim uljen e rrezikut të migrimit të parregullt dhe keqpërdorimit të regjimit

pa viza.

Kjo çështje përmendet rregullisht në raportet vjetore të progresit të Komisionit Evropian, si dhe në raportet për Mekanizmin e Pezullimit të Vizave, i cili monitoron nëse vendet që gëzojnë regjim pa viza me BE-në, vazhdojnë t'i përmbushin kushtet për ta ruajtur atë.

Nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Bosnje dhe Hercegovinë thonë për Radion Evropa e Lirë se nga ky vend, si kandidat për anëtarësim në BE, pritet harmonizimi më tejshëm i politikës së vizave me listën e vendeve të treta, shtetasit e të cilave kanë nevojë për vizë për të hyrë në Bashkimin Evropian, veçanërisht kur bëhet fjalë për shtete që paraqesin rrezik migrimi ose të sigurisë.

Ata rikujtojnë se Bosnje dhe Hercegovina, përmes Agjencës së Reformave, është zotuar që në periudhën 2025-2027 të shfuqizojë çdo vit nga një marrëveshje për regjim pa viza me një vend, shtetasit e të cilit kanë nevojë për vizë për të hyrë në BE.

Ministri i Jashtëm i Bosnje dhe Hercegovinës, Elmedin Konaković, ka thënë më herët se, deri në fund të këtij viti, vendi do të vendosë regjim vizash për një nga këto shtete, pa bërë të ditur se për cilin prej tyre bëhet fjalë.

Megjithatë, ai ka theksuar se

“nuk është reale” që kjo të vlejë për Turqinë, Kinën ose Rusinë.

Bosnje dhe Hercegovina mban regjim të përhershëm pa viza me shtatë vende, shtetasit e të cilave kanë nevojë për vizë për të hyrë në Bashkimin Evropian: Azerbajxhanin, Kinën, Katarin, Rusinë, Turqinë, Kuvajtin dhe Vanuatun.

Përveç kësaj, ajo zbaton edhe heqje sezonale të vizave, kryesisht gjatë verës, për Bahrejin, Omanin dhe Arabinë Saudite - një praktikë që nuk është në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Policia Kufitare e Bosnje dhe Hercegovinës thotë për Radion Evropa e Lirë se gjatë vitit 2025 janë regjistruar 147.910 hyrje të shtetasve të Kinës dhe 125.088 hyrje të shtetasve rusë.

Ndërkaq, nga 1 janari deri më 16 qershor 2026 janë regjistruar 55.359 hyrje të shtetasve kinezë dhe 51.001 hyrje të shtetasve rusë.

Denis Avdagić, analist i politikës së jashtme në Institutin për Strategji të Reja Mediale (INMS) në Zagreb, thotë se nëse Bosnje dhe Hercegovina nuk arrin t'i përmbushë këto kërkesa, ajo do të dërgojë mesazh të qartë për Brukselin. “Nuk mund t'i zgjidhin të gjitha problemet përfaqësuesit e lartë. Një pjesë e përgjegjësisë u takon edhe qytetarëve. Nëse dikush dëshiron t'i mbajë qytetarët

peng të politikave, sidomos atyre ndaj Rusisë, atëherë ata duhet ta dinë se, sipas sondazheve më të fundit, më shumë se gjysma e qytetarëve në Republikën Serpska janë pro anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ndërsa mbështetja në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës dhe në Distriktin e Bërçkos është ndër më të lartat nga të gjitha vendet kandidatë”, thotë Avdagiq.

“Ballkani Perëndimor nuk mund të bëjë përjashtim”

Avdagiq thotë se harmonizimi i politikës së vizave është një kërkesë që Bashkimi Evropian ua parashtron të gjitha vendeve kandidatë, prandaj as vendet e Ballkanit Perëndimor nuk mund të bëjnë përjashtim.

Ai thekson se është e qartë se vendosja e regjimit të vizave nuk është një dëshirë politike e shteteve të veçanta. “Nëse ky kusht është vendosur për të gjithë dhe të tjerët e kanë pranuar kërkesën për harmonizimin e regjimit të vizave me atë të vendeve anëtare të BE-së, atëherë gjërat janë krejtësisht të qarta”, thotë Avdagiq.

Viza për rusët në Mal të Zi deri në shtator?

Mali i Zi është vendi i parë në rajon që, nën presionin e Bashkimit Evropian, do ta heqë regjimin pa viza për shtetasit rusë.

Në nëntor të vitit 2025, Qeveria

e Malit të Zi njoftoi se regjimi i vizave për shtetasit rusë do të vendoset më së voni deri në shtator të vitit 2026.

Kjo masë është pjesë e obligimeve që Mali i Zi ka marrë në kuadër të harmonizimit me rregullat e Bashkimit Evropian, në Kapitullin 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria.

Ministria e Punëve të Jashtme e Malit të Zi konfirmoi për Radion Evropë e Lirë më 26 qershor se shtetasit rusë do të kenë nevojë për vizë për të hyrë në Mal të Zi dhe se pa këtë masë nuk do të jetë e mundur të mbyllet Kapitulli 24 i negociatave me BE-në.

Ministria bëri të ditur se më 2 qershor 2026 ka nisur pranimin e kërkesave për viza përmes kompanisë VFS Global në disa qytete të Federatës Ruse.

Sipas saj, kjo do ta lehtësojë ndjeshëm pajisjen me viza malazeze për shtetasit rusë dhe do t'i minimizojë sa më shumë pasojat e heqjes së regjimit pa viza.

Nga numri i përgjithshëm i shtetasve të huaj që hyjnë në Mal të Zi gjatë një viti, rusët zakonisht renditen të dytët, menjëherë pas shtetasve të Serbisë.

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, të zhvilluar në shtator të vitit 2024, 13.550 shtetas rusë me qëndrim të përhershëm jetojnë në Mal të Zi - më shumë se çdo grup tjetër i shtetasve të huaj.

Megjithatë, të dhënat zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme tregojnë një shifër edhe më të lartë, sipas së cilës në Mal të Zi ndodhen 23.330 shtetas rusë.

Mali i Zi mbështetet në masë të

madhe të turizmi, pasi të ardhurat nga ky sektor përbëjnë rreth një të katërtën e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB).

Turistët rusë janë ndër më të shumtët që vizitojnë këtë vend. Sipas Entit të Statistikave të Malit të Zi, gjatë vitit 2025, turistët rusë realizuan 16 për qind të të gjitha netqëndrimeve të turistëve të huaj në vend, duke u renditur të dytët pas turistëve nga Serbia, të cilët përbënin 23 për qind.

Edhe pse Mali i Zi ka vendosur sanksione ndaj Moskës në vitin 2022, për shkak të pushtimit të Ukrainës, Bashkimi Evropian ka theksuar vazhdimisht se harmonizimi i politikës së vizave është një kusht kyç për përparimin në negociatat e anëtarësimit.

Mali i Zi konsiderohet vendi me gjasat më të mëdha për t'u bërë anëtar i BE-së deri në fund të kësaj dekade.

Deri tani, ai ka mbyllur 16 nga 33 kapitujt e negociatave të anëtarësimit.

Sa u përket shtetasve kinezë, Enti i Statistikave i Malit të Zi regjistroi rritje të numrit të vizitorëve nga Kina.

Gjatë vitit 2025, numri i mbërritjeve nga Kina (82.054) tejkaloi rekordin e mëparshëm të vitit 2019.

Megjithatë, shtetasit kinezë nuk mund të hyjnë individualisht në Mal të Zi pa vizë.

Për udhëtimet turistike në grup zbatohen rregulla të veçanta: përmes agjencive turistike malazeze që bashkëpunojnë me agjenci kineze, ata mund të pajisen me letra ftese dhe, nëse kanë rezervuar një paketë turistike, të qëndrojnë në Mal të

Zi deri në 30 ditë.

Serbia stagnon

Sa i përket Serbisë, pavarësisht thirrjeve të vazhdueshme nga Bashkimi Evropian, ajo nuk ka vendosur ende sanksione ndaj Rusisë, edhe më shumë se katër vjet pas fillimit të luftës në Ukrainë.

Shtetasit rusë mund të hyjnë dhe të qëndrojnë në Serbi deri në 30 ditë pa vizë.

Që nga viti 2022, kur ka nisur lufta, një numër i madh rusësh janë zhvendosur në Serbi.

Sipas regjistrimit të popullsisë të atij viti, në këtë vend jetonin mbi 10.000 shtetas rusë, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme njoftoi se numri i rusëve që qëndronin në Serbi ishte mbi 30.000.

Sipas vlerësimeve të organizatave joqeveritare, numri i shtetasve rusë në Serbi është edhe më i lartë.

Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë vlerëson se, nga fillimi i agresionit rus ndaj Ukrainës e deri në fund të vitit 2024, më shumë se 67.000 shtetas rusë kanë marrë leje të përkohshme qëndrimi në Serbi.

Edhe shtetasit kinezë, prej vitesh, janë ndër turistët më të shumtë në Serbi.

Ata mund të hyjnë dhe të qëndrojnë në këtë vend deri në 30 ditë pa vizë.

Sa i përket Kosovës, ajo nuk ka marrëdhënie diplomatike me Kinën, pasi Pekini nuk e njeh pavarësinë e saj.

Për këtë arsye, shtetasit kinezë nuk mund të hyjnë në Kosovë pa vizë.

I njëjti rregull vlen edhe për shtetasit rusë, të cilët gjithashtu kanë nevojë për vizë për të hyrë dhe qëndruar në Kosovë.

Maqedonia e Veriut, po ashtu, kërkon vizë si për shtetasit e Kinës, ashtu edhe për ata të Rusisë.

“Është e qartë pse Rusia dhe Kina...”

Duke folur për aspektin e sigurisë, analisti i politikës së jashtme, Denis Avdagiq, thotë se nuk mund të vlerësojë raste të veçanta të keqpërdorimit të regjimit pa viza, por shton se shtetasit rusë janë lidhur edhe më herët me aktivitetet hibride.

“Dihet se shtetasit rusë janë përfshirë më herët në aktivitete hibride, jo vetëm në vendet e Ballkanit Perëndimor, por edhe brenda Bashkimit Evropian. Ndërsa në BE është shumë e vështirë të kalohen kontrollet e sigurisë, qoftë për marrjen e vizës apo hyrjen në territorin e saj, situata në Ballkan është ndryshe, veçanërisht kur ekziston një regjim i liberalizuar i vizave për shtetasit rusë”, thotë Avdagiq.

Sipas tij, harmonizimi i politikës së vizave është para së gjithash një test politik për vendet që synojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian. “Nëse e shohim në tërësi, është e qartë për të gjithë pse pikërisht Rusia dhe Kina janë një çështje veçanërisht sfiduese për Bashkimin Evropian. Pikërisht në këto tema, vendet kandidatë duhet të dëshmojnë se sa seriozisht e dëshirojnë anëtarësimin në BE”, përfundon Avdagiq.



FSK-ja avancon kapacitetet e komunikimit, diplomohen 12 kursantë të Kursit Harris

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Dymbëdhjetë kursantë kanë përfunduar me sukses Kursin e Komunikimit Niveli 2, kursantët fituan njohuri dhe aftësi të avancuara në konfigurimin, instalimin, programimin dhe funksionalizimin e sistemeve të komunikimit Harris. Gjatë kursit, pjesëmarrësit u trajnuan në përdorimin e

sistemeve moderne të komunikimit ushtarak, të cilat mundësojnë komunikim të sigurt, të besueshëm dhe efektiv në operacione, ushtrime dhe aktivitete të ndryshme taktike.

Sistemet Harris përdoren gjerësisht nga forcat e armatosura të vendeve partnere dhe kontribuojnë në ndërveprueshmërinë ndërmjet

njësive dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Realizimi i këtij kursi kontribuon në ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit të komunikimit dhe në forcimin e aftësive operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke siguruar mbështetje efektive të komandimit dhe kontrollit në të gjitha nivelet e operacioneve.



KURTI E HAXHIU: BE-ja DUHET T'I PËRGGJIGJET VULLNETIT TË KOSOVËS PËR ANËTARËSIM

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 QERSHOR - U.d. presidentja e Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, priti të martën në takim Valentina Superti, drejtoreshë për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian, gjatë vizitës së saj të parë në Kosovë.

Haxhiu vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të BE-së për zhvillimin e vendit dhe theksoi se Kosova e ka kthyer këtë mbështetje në institucione demokratike, në reforma dhe në një orientim të qartë evropian, i cili gëzon mbështetje shumë të lartë qytetare.

U.d. presidentja theksoi se Kosova ka mbajtur kurs të qartë në reformat evropiane, është plotësisht e harmonizuar me politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së, dhe po i zbaton me seriozitet obligimet që dalin nga Agjenda e Reformave dhe Plani i Rritjes.

Ajo kërkoi që progresi i Kosovës të marrë përgjigje të qartë politike nga Bashkimi Evropian përmes avancimit drejt statusit



kandidat dhe hapjes së negociatave të anëtarësimit. Haxhiu theksoi gjithashtu rëndësinë e zbatimit të marrëveshjeve të Procesit të Berlinit dhe të bashkëpunimit të barabartë rajonal, ku Kosova duhet të trajtohet me të njëjtën mundësi për përfaqësim, lidhje infrastrukturore, tregti, digjitalizim dhe qasje në iniciativat e tregut të përbashkët. Edhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka pritur në takim drejtoreshën për Zgjerim dhe

Fqinjësi të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, Valentina Superti, në vizitën e saj të parë në Republikën e Kosovës. Kurti ka thënë se vendi ynë është lider rajonal në sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit, të drejtat politike e liritë civile, si dhe në indeksat e zgjedhjeve dhe demokracive liberale. "Krahas linjësimit të plotë me politikën e jashtme dhe të sigurisë me BE-në, si dhe përparimit në përbushjen e reformave evropiane, ne kemi shënuar



rritje të vazhdueshme ekonomike dhe për herë të parë pas 15 vjetësh Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar na kanë larguar nga listat e vendeve të brishta dhe të ndikuara nga konfliktet. Bashkimi Evropian është kontribues i madh në zhvillimin e Republikës sonë, ndërsa anëtarësimi është qëllimi dhe e ardhmja e Kosovës. Vullnetit të popullit tonë për anëtarësim, BE-ja duhet t'i përgjigjet me vullnet të ndërsjellë për praninë.

Statusi i vendit kandidat dhe hapja e negociatave, janë pikënisje e një procesi nga i cili Kosova forcon demokracinë dhe zhvillohet edhe më shumë", ka thënë Kurti pas takimit. Ai ka treguar se në takim biseduan edhe për Planin e Rritjes, integrimin në zonën "Roam Like at Home", Procesin e Berlinit, bashkëpunimin rajonal dhe përfaqësimin e barabartë, sikurse edhe infrastrukturën, tregtinë, digjitalizimin e arsimin.

BQK-ja DORËZON NË KUVEND RAPORTIN VJETOR 2025



PRISHTINË, 30 QERSHOR - U.D. presidentja e Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, priti të martën në takim guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Ahmet Ismaili, i cili i dorëzoi Raportin Vjetor të BQK-së për vitin 2025.

Dorëzimi i Raportit u bë në përputhje me dispozitat e neneve 28 dhe 59 të Ligjit 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, përmes të cilave përcaktohet detyrimi i BQK-së për të raportuar para Kuvendit si institucioni më i lartë përfaqësues i vendit.

Me këtë rast, guvernatori Ismaili njoftoi u.d. presidenten Haxhiu për përbajtjen kryesore të Raportit Vjetor 2025, i cili pasqyron aktivitetet, zhvillimet dhe rezultatet e BQK-së në përbushje të mandatit të saj kushtetues dhe ligjor për ruajtjen e stabilitetit financiar, forcimin e integritetit të sistemit financiar dhe sigurimin e qëndrueshmërisë institucionale. Ai theksoi se ekonomia dhe sistemi financiar i vendit ruajtën stabilitetin gjatë vitit 2025, ndërsa sektori bankar mbeti i mirëkapitalizuar dhe me

likuiditet të lartë.

U.d. presidentja Haxhiu vlerësoi punën e Bankës Qendrore gjatë vitit 2025, duke theksuar kontributin e saj në ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar, përkundër sfidave që buruan nga zhvillimet ekonomike dhe gjeopolitike në nivel ndërkombëtar. Në këtë takim, Haxhiu çmoi pavarësinë dhe integritetin institucional të Bankës Qendrore, duke ritheksuar përkushtimin për ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme dhe llogaridhënese.

Spiropali: Po punojmë për draftin e Shqipërisë së re, do të vazhdoj të jem pjesë e PS-së

TIRANË, 30 QERSHOR - Deputetja e Partisë Socialiste, Elisa Spiropali, ka theksuar në një deklaratë për mediat teksta hynte në Kuvend se puna për draftin për Shqipërinë e re po vijon.

Spiropali theksoi se mbetet pjesë e Partisë Socialiste, ndërsa u shpreh se fokusi kryesor është puna për të ardhmen e vendit. "Jemi duke punuar. E rëndësishme është ajo që do të bëjmë për

Shqipërinë. Unë jam në Partinë Socialiste, kam qenë dhe do të jem. Në PS duhet të jenë të gjithë ata që kërkojnë një Shqipëri më të mirë; e kanë bërë këtë historikisht dhe po e bëjnë edhe sot", deklaroi

Spiropali.

E pyetur nga Euronews Albania nëse në hartimin e këtij drafti po bashkëpunon edhe me figura të tjera të Partisë Socialiste, si Ditmir Bushati, Spiropali nuk dha një përgjigje.



GLPS-JA PARALAJMËRON RREZIK PËR HUMBJE FINANCIARE NGA PLANI I RITJES, PËRMENDEN 90.6 MILIONË EURO TË RREZIKUARA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka mbajtur të martën një konferencë për media lidhur me zbatimin e Agjendës së Reformave të Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe pasojat serioze që vonesat në reforma dhe financim po shkaktojnë për Kosovën. "Kjo datë po ashtu shënon përfundimin e semestrit të katërt të Planit dhe fillimin e humbjeve financiare për Kosovën nga ky instrument. Që nga sot nuk ka më thjesht vonesa në ekzekutim të fondeve, por rrezikohen humbje të parikuperueshme financiare. Në diskutim janë 90.6 milionë euro të dedikuara për semestrin e dytë me afat përfundimi me 30 qershor 2025. Pas kësaj date u aktivizua grejs periudha një vjeçare, kohë gjatë së cilës qeveria dhe kuvendi kishin kohë shtesë për të zbatuar 13 hapat reformues të planifikuar për këtë semester, pa humbje financiare. Megjithatë, me përmbylljen e kësaj periudhe, pasojat financiare janë të konsiderueshme dhe të pakthyeshme, dhe shumë shpejtë do ketë një qartësi se sa nga këto mjete janë humbur përfundimisht", është thënë në

komunikatën e GLPS-së. Sipas kësaj komunikate, ky proces nuk përbën çështje teknike apo administrative, por çështje të drejtpërdrejta të interesit publik. "Çdo euro e humbur nënkupton zvogëlim të investimeve në ekonomi, dobësim të mbështetjes për reforma, kufizim të mundësive zhvillimore dhe cenim të besueshmërisë së Kosovës në procesin e Integritimit Evropian. Duke konsideruar rrethanat e atëhershme si pasojë e krizës politike, GLPS kishte paralajmëruar këtë skenar që me 2 maj 2025, duke bërë thirrje për ratifikimin e menjëhershëm të marrëveshjeve dhe zbatimin e plotë e të koordinuar të Agjendës së Reformave. Në atë kohë, është ngritur shqetësimi se mungesa e veprimit institucional në kohë do të rezultonte në humbje financiare dhe në dobësim të kapaciteteve reformuese të shtetit. Pavarësisht këtyre paralajmërimeve, institucionet kompetente në atë periudhë kanë mohuar mundësinë e humbjeve financiare, por zhvillimet kanë dëshmuar të kundërtën duke konfirmuar rreziqet e identifikuar", thuhet në komunikatë. Sipas GLPS-së, Plani i Rritjes, në mënyrë indirekte, është ndikuar ndjeshëm nga mungesa e



konsensusit politik në vend përndërtimin e institucioneve stabile dhe funksionale në afat të gjatë, duke krijuar kështu hapësirë për kriza të njëpasnjëshme politike dhe institucionale. "Në mungesë të një Ekzekutivi dhe Kuvendi plotësisht funksional dhe të koordinuar, një numër i konsiderueshëm i reformave të domosdoshme nuk është zbatuar. Pas publikimit të raporteve zyrtare të zbatimit nga Qeveria e Kosovës dhe BE, do të mundësohet një pasqyrë e qartë dhe e bazuar mbi: nivelin e fondeve të zbllokua deri më sot, vlerësimin e fondeve të rrezikuara për humbje pas

përfundimit të afateve, listën e reformave të papërbushura, si dhe planin institucional për minimizimin e humbjeve të mëtejshme", thuhet tutje në komunikatë. Duke konsideruar gjendjen aktuale, GLPS rithekon rekomandimet e saj për përmirësimin dhe përsheptimin e zbatimit të Agjendës së Reformave, përmes themelimit të një task-force të dedikuar për koordinimin dhe zbatimin e reformave të planifikuara në kuadër të Agjendës së Reformave; Prioritizimit të qartë dhe të strukturuar të masave të Agjendës së Reformave; Të përpilohet lista e

ligjeve me prioritet dhe të trajtohen me prioritet, pa i humbur aspektin kualitativ si dhe konsultimet e rregullta. GLPS-ja ka theksuar se formimi i institucioneve dhe koordinimi i qëndrueshëm institucional mbeten kushti kryesor për të siguruar përfitim substancial të fondeve të parapara në kuadër të Planit të Rritjes. Në këtë kuptim, GLPS-ja thekson se stabiliteti institucional dhe ritmi i vendimmarrjes do të jenë faktorë përcaktues në shmangien e humbjeve të mëtejshme financiare. "Çdo vonesë shtesë në formimin dhe funksionalizimin e institucioneve mund të ketë pasojë të drejtpërdrejta në përfitimet financiare të vendit dhe në avancimin e reformave që ndikojnë në funksionimin e institucioneve dhe në jetën e përditshme të qytetarëve", është thënë në komunikatën e GLPS-së. GLPS-ja u bën thirrje institucioneve përgjegjëse që këtë çështje ta trajtojnë me seriozitetin e plotë që kërkon rëndësia e saj strategjike dhe financiare. "Përgjegjësia publike nuk matet me deklarime, por me aftësinë për të mbrojtur interesin zhvillimor dhe financiar të qytetarëve të Republikës së Kosovës", është thënë në komunikatën për media të GLPS-së.

SHSKUK-ja IA VAZHDON MANDATIN ELVIR AZIZIT SI DREJTOR I PËRGJITHSHËM

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) ka vendosur të vazhdojë mandatin e drejtorit të përgjithshëm, Elvir Azizi, duke e riemëruar në këtë pozitë. Sipas njoftimit të SHSKUK-së, vendimi është marrë në bazë të kompetencave ligjore dhe statutove të Bordit, duke u mbështetur në rezultatet e arritura gjatë periudhës së udhëheqjes së Azizit dhe në nevojën për të siguruar vazhdimësi institucionale. SHSKUK-ja njofton se gjatë periudhës 2023 - 2025 janë shënuar përmirësime në treguesit kryesorë të performancës. Numri i pacientëve të hospitalizuar është rritur për 11.9 për qind, operimet për 12.5 për



qind, vizitat ambulatorie për 24.6 për qind, shërbimet laboratorike për 20.5 për qind, ekzaminimet CT për 12.7 për qind, ndërsa ato me MRI kanë shënuar rritje prej 71 për qind. Po ashtu, është rritur edhe volumi i shërbimeve të kardiologjisë invazive, me 11.9 për qind më shumë koronarografi dhe 13.3 për qind më shumë implantime të stentave. Në njoftim përmenden edhe projektet e realizuara gjatë kësaj periudhe, përfshirë funksionalizimin e Cath Lab-it në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit, investimet në Mjekësinë Nukleare, zgjerimin e kapaciteteve të Kardiokirurgjisë, hapjen e shërbimeve të reja në spitalet e përgjithshme, zhvillimin e programit të fertilizimit të asistuar

(IVF), investimet në Qendrën Stomatologjike Universitare të Kosovës, si dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë, përfshirë LuxDev dhe GIZ. Bordi Drejtues thekson se sistemi shëndetësor vazhdon të përballet me sfida, si listat e pritjes, mungesat periodike të materialeve dhe nevoja për shtim të personelit e investimeve. Megjithatë, sipas Bordit, vazhdimësia në menaxhim është e domosdoshme për përfundimin e reformave dhe projekteve strategjike në proces. Sipas njoftimit, vendimi për riemërimin e Azizit synon të sigurojë stabilitet institucional, vazhdimësi të projekteve zhvillimore dhe konsolidim të mëtejshëm të sistemit shëndetësor publik në Kosovë. (KP)

Haziri: Kosova u penalizua në Samitin e NATO-s, shkak mungesa e stabilitetit institucional

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka reaguar pas Samitit të NATO-s në Ankara, duke vlerësuar se Kosova është penalizuar me

mosmarrjen e ftesës për të marrë pjesë. Sipas Hazirit, mungesa e ftesës është pasojë e krizës së brendshme politike dhe mungesës së stabilitetit institucional. "Kosova u

penalizua në Samitin e NATO-s në Ankara. Pa dyshim, mosardhja e ftesës ndodhi si pasojë e mungesës së stabilitetit institucional. Bota po ndryshon, por jo ne. Në qarkun e mbyllur vicioz e

me kriza politike. Është koha e fundit për reflektim të thellë. Veç bashkëpunimi për procese politike e normalizon dhe e stabilizon Republikën. Republika mbi të gjithë!", ka shkruar Haziri në "Facebook".



Rritet numri i bizneseve të reja në Kosovë

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, njofton se, sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 është shënuar rritje e numrit të bizneseve të reja të regjistruara krahasuar me të

njëjtën periudhë të vitit 2025. Sipas statistikave të ARBK-së, në periudhën 1 janar - 29 qershor 2026 janë regjistruar gjithsej 6,834 biznese të reja, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit paraprak, 1 janar - 29 qershor 2025, janë regjistruar 6,545 biznese. Kjo paraqet një rritje prej 289 bizneseve, më shumë krahasuar

me gjashtëmujorin e parë të vitit 2025. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit dhe ARBK-ja, mbeten të përkushtuar në krijimin e kushteve sa më të favorshme për zhvillimin e bizneseve dhe promovimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.



BQK-ja PJESËMARRËSE NË TAKIMIN E KONSTITUENCËS SË FMN-së DHE GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE NË PRAGË

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Dardan Fusha, mori pjesë në takimin e radhës të Konstituencës së Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Grupit të Bankës Botërore, të mbajtur në nivel të zëvendësve, në Pragë të Republikës Çeke, ku morën pjesë përfaqësues të bankave qendrore dhe ministrive të financave nga vendet anëtare të Konstituencës, përfshirë Austrinë, Belgjikën, Republikën Çeke, Hungarinë, Kosovën, Luksemburgun, Sllovakinë, Slloveninë dhe Turqinë.

Takimi u zhvillua në një periudhë të karakterizuar nga ndryshime të rëndësishme në ekonominë globale, pas një varg sfidash të njëpasnjëshme, përfshirë pandeminë Covid-19, konfliktet gjeopolitike, vazhdimin e pasigurive në tregjet ndërkombëtare, sigurinë energjetike dhe tranzicionin drejt burimeve të ripërtëritshme të energjisë, si dhe ndryshimet dhe



ndërprerjet në zinxhirët globalë të furnizimit. Diskutimet u përqendruan në zhvillimet aktuale ekonomike dhe financiare globale, perspektivën makroekonomike, forcimin e reziliencës së ekonomive, si dhe rolin e

institucioneve financiare ndërkombëtare në mbështetjen e reformave dhe përballimin e sfidave të reja.

Gjatë takimit u vlerësua rëndësia e institucioneve të qëndrueshme, qeverisjes së mirë dhe politikave të kujdesshme ekonomike, si faktorë kyç për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm.

Në këtë kuadër, u diskutuan edhe përvojat e vendeve anëtare me programet dhe vlerësimet e ofruara nga FMN dhe Banka Botërore, përfshirë Programet e Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP), të cilat të shoqëruara me asistencë specifike teknike, kontribuojnë në forcimin e kuadrit të stabilitetit financiar, mbikëqyrjes financiare, menaxhimit të krizave dhe përgatitjes institucionale ndaj reziqeve të reja.

Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e përshtatjes së vazhdueshme të politikave dhe kornizave institucionale me

zhvillimet e reja, përfshirë digitalizimin e ekonomisë, inovacionet financiare, rreziqet që lidhen me teknologjitë e reja, si dhe ndikimet e tranzicionit të gjelbër dhe ndryshimeve klimatike në stabilitetin financiar. Në kuadër të diskutimeve, u vlerësua pozitivisht progresi i Kosovës në zbatimin e programit me Fondin Monetar Ndërkombëtar, përfshirë Marrëveshjen Stand-By (SBA) dhe Programin për Reziliencë dhe Qëndrueshmëri (RSF).

Programi RSF, si instrumenti i parë i këtij lloji i aprovuar nga FMN në Evropë, ka mbështetur reformat afatgjatë të Kosovës në drejtim të forcimit të reziliencës ekonomike, tranzicionit energjetik dhe përmirësimit të kornizave institucionale për përballimin e sfidave të ardhshme. Zbatimin e suksesshëm i këtyre programeve ka kontribuar në forcimin e besimit të partnerëve ndërkombëtarë dhe mbështetjen e reformave strukturore. Gjithashtu, gjatë takimit u

diskutua rëndësia e investimeve në infrastrukturë kritike, lidhjeve rajonale dhe integritet ekonomik, me theks në rolin e qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, transformimit digjital dhe integritet me infrastrukturat evropiane si faktorë për rritjen e produktivitetit dhe zhvillimin afatgjatë.

Takimi përfundoi me rikonfirmimin e rëndësisë së bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet vendeve anëtare të Konstituencës dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, me qëllim shkëmbimin e përvojave, koordinimin e politikave dhe ndërtimin e një të ardhmeje më të qëndrueshme, duke rritur gatishmërinë institucionale për përballimin e pasigurive dhe reziqeve të reja të mundshme, përfshirë ato që lidhen me zhvillimet gjeopolitike, por edhe me sigurinë kibernetike dhe ndikimin e mundshëm të teknologjive të avancuara, si inteligjenca artificiale dhe kompjuterëve kuantik.

MIRATOHET RAPORTI VJETOR I BQK-së PËR VITIN 2025: KONFIRMOHET STABILITETI FINANCIAR

Prishtinë, 30 qershor- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka miratuar raportin vjetor për vitin 2025, i cili pasqyron angazhimet, zhvillimet dhe arritjet institucionale në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar, forcimit të integritetit të sistemit financiar dhe qëndrueshmërisë institucionale. Raporti konfirmon se ekonomia e Kosovës dhe sistemi financiar kanë ruajtur stabilitetin dhe qëndrueshmërinë, pavarësisht sfidave nga mjedisit i jashtëm

ekonomik dhe gjeopolitik. Gjatë vitit 2025, sistemi financiar vazhdoi zgjerimin e qëndrueshëm, sektori bankar mbeti mirë i kapitalizuar dhe likuid, ndërsa norma e kredive joperformuese mbeti në nivel të ulët.

Gjatë vitit, BQK-ja avancoi kornizën makroprudenciale, mbikëqyrjen e sistemit financiar, harmonizimin rregullativ me standardet e Bashkimit Evropian, sistemin e pagesave, mbrojtjen e konsumatorit, gjithëpërfshirjen



financiare, inovacionin financiar dhe integritetin e valutës euro në Kosovë. Në planin ndërkombëtar, BQK-ja forcoi praninë në forume

rajonale dhe ndërkombëtare, zgjeroi bashkëpunimin përmes asistencave të ndryshme teknike dhe avancoi menaxhimin e rezervave ndërkombëtare, në mbështetje të reformave, kapaciteteve institucionale dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare. Raporti përfshin edhe pasqyrat financiare të audituara të BQK-së për vitin 2025, me opinion të pamodifikuar nga auditori i jashtëm. Për vitin 2025, BQK-ja realizoi

rezultat financiar pozitiv prej 24 milionë euro, me ndarje të fitimit në përputhje me kornizën ligjore: 50% për buxhetin e Republikës së Kosovës dhe 50% për rezervat e BQK-së.

Falënderim i veçantë për stafin e BQK-së, organet drejtuese dhe mbikëqyrëse, si dhe për partnerët vendorë institucionale dhe ndërkombëtarë për bashkëpunimin, mbështetjen dhe kontributin në avancimin e reformave dhe objektivave strategjike të BQK-së.

Auditorja e Përgjithshme zhvilloi vizitë në Gjykatën Evropiane të Auditorëve

Prishtinë, 30 qershor- Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, dhe Zëvendës Auditori i Përgjithshëm, Beza Halilaj, me bashkëpunëtorë, zhvilluan vizitë pune në Gjykatën Evropiane të Auditorëve (GjEA), në Luksemburg. Spanca dhe zyrtarët e ZKA-së, u pritën në takim nga zyrtarë të lartë të GjEA, ndërkaq në kuadër të vizitës u zhvillua një program i gjerë prezantimesh

dhe diskutimesh mbi funksionimin e Gjykatës, rolin e saj në mbikëqyrjen e financave të Bashkimit Evropian (BE), si dhe sfidat në auditimin e projekteve të financuara nga BE.

Gjatë vizitës delegacioni i ZKA-së po ashtu u njoh nga afër me punën e Dhomës III të GjEA, e cila mbulon fushat e veprimtimit të jashtëm, sigurisë dhe drejtësisë ku diskutimet u përqendruan

në analizën kost-benefit, vlerësimin e rrezikut dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të projekteve të financuara nga BE-ja.

Në kuadër të vizitës, delegacioni zhvilloi gjithashtu një vizitë në Zyrën e Prokurorit Publik Evropian, ku u diskutua për bashkëpunimin institucional dhe mekanizmat për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian.



'MAGJISTARI I KREMLINIT', OSE RASPUTINI I KOHËVE MODËRNE



Paul Dano dhe Jude Law luajnë në filmin "Magjistari i Kremlinit", mbi ngjitjen në pushtet të Vladimir Putin dhe një versioni të krijuar, të njeriut të tij më të afërt.

Historia është e mbushur me rrëfime për njeriun që qëndron prapa njeriut: atë që tërhiqte fijet, orkestronte lëvizjet dhe i shihte të gjitha të ndodhnin nga prapaskena. Edhe pse një tekst në fillim të "Magjistari i Kremlinit", me regji të Olivier Assayas, na kujton se filmi është "një vepër artistike me karakter fikcional", ai bazohet pjesërisht në historinë e një njeriu të tillë: Vladislav Surkov, politikan dhe biznesmen rus, i cili ishte një nga ndihmësit më të afërt të presidentit rus Vladimir Putin, deri sa u shkarkua papritur në vitin 2020.

Për disa, Surkov ishte një eminencë gri në Kremlin, por edhe një mjeshtër i propagandës politike, që manipulonte mediat për të ruajtur kontrollin.

Në film, alter egoja e tij është Vadim Baranov (Paul Dano), një burrë me sjellje të qetë dhe shije të rafinuar për artin dhe letërsinë. Skenari, i shkruar nga Assayas së bashku me Emmanuel Carrère, bazohet në romanin e vitit 2022 të Giuliano da Empolit.

Filmi na prezanton me Baranovin përmes një gazetari dhe studiuesi amerikan të

Rusisë, Lawrence Rowland (Jeffrey Wright). Rowland ka botuar në revistën Foreign Affairs një artikull me titull "Vadim Baranov dhe shpikja e demokracisë së rreme", i cili duket se ka tërhequr vëmendjen e vetë Baranovit. Gjatë një qëndrimi në Moskë në vitin 2019, Rowland shkëmben mesazhe në rrjetet sociale për romanin proto-oruellian të vitit 1924 "Ne", të shkrimtarit bolshevik Yevgeny Zamyatin, me një person të panjohur. Kur pranon ftesën për t'u takuar në shtëpinë e këtij personi në fshat, zbulon se bëhet fjalë pikërisht për Baranovin.

Që prej këtij momenti, "Magjistari i Kremlinit" merr formën e një historie brenda historisë. Baranovi e udhëheq Rowland-in nëpër jetën e tij, duke i treguar se çfarë kishte kuptuar drejt dhe çfarë gabim në artikullin e tij. Por në të vërtetë duket sikur Baranovi po rikthehet në kujtimet e veta në kërkim të përgjigjes së një pyetjeje që as ai vetë nuk arrin ta formulojë plotësisht.

Rrëfimi nis me jetën e tij si student në fillim të viteve 1990, në Rusinë e re, menjëherë pas shembjes së komunizmit sovjetik. Gjithçka duket e mundur dhe paratë qarkullonin pa kufi. Në kujtimet e Baranovit, ajo periudhë ishte si një festë e pafundme, ose ndoshta një orgji, ku në një

festë private mund të shihje një burrë lakuriq me zinxhir që ndiqte një këngëtare punk.

Si student e më pas regjisor i teatrit avangardë, ai jetonte mes artit dhe poezisë bashkë me të dashurën e tij, Ksenia (Alicia Vikander). Kur në jetën e tyre hyn Dmitri Sidorov (Tom Sturridge), një biznesmen vulgar, por argëtues dhe themelues i bankës së parë tregtare ruse, gjithçka fillimisht bëhet më e ndritshme, e më pas më e errët.

Më vonë Baranovi kalon në një punë në prodhimin e televizioneve të reality show-ve, dhe pikërisht aty historia fillon të marrë formën që njohim.

"Magjistari i Kremlinit", nga entuziasmi tek oligarkët dhe Putini

Në thelb, "Magjistari i Kremlinit" është një film mbi mënyrën se si Rusia kaloi nga entuziazmi i viteve të para pas Bashkimit Sovjetik, te ngritja e oligarkëve dhe, më pas, te vendosja e Vladimir Putin (një Jude Law pothuajse rrëqethës në interpretim) në krye të shtetit. Ish-oficeri i KGB-së e vlerësonte pushtetin më shumë sesa paranë. Oligarkët që e zgjodhën Putinin si pasues të Boris Yeltsinit e kuptojnë shumë vonë se ai nuk do të

ishte kukulla e tyre.

"Ajo që më intereson është rikthimi i integritetit të Federatës Ruse," i thotë ai Baranovit.

Dhe kjo nënkupton një gjë: përqendrimin e pushtetit tek vetja.

Baranovi, falë talentit të tij për të ndërtuar rrëfime bindëse, bëhet i dobishëm për Putinin. Në këtë pikë, ai ka humbur pothuajse çdo idealizëm. Teksa bëhet gjithnjë e më nihilist, duke besuar se e vërteta është çfarëdo që ai vendos të jetë, edhe vendi i tij merr të njëjtin drejtim. Përvoja në teatër dhe televizion rezultojnë ideale: ai shndërrohet në një gjeni të komunikimit politik, duke kuptuar se si teatri politik mund të mos pasqyrojë realitetin, por ta krijojë atë. Për këtë arsye, njerëzit fillojnë ta quajnë "Rasputini i Ri."


Siç mund ta keni kuptuar edhe nga aktorët, "Magjistari i Kremlinit" nuk është në gjuhën ruse. Aktorët flasin anglisht, çka sugjeron se filmi është menduar si një interpretim i historisë ruse për publikun ndërkombëtar. Edhe pse zgjat 136 minuta, ai mbulon një periudhë shumë të gjerë historike me një ritëm të shpejtë. Kjo krijon një efekt interesant dramatik: historia rrjedh përmes syve të Baranovit në linja të mëdha, ndërsa figura si Putini, që zakonisht i shohim

çdo ditë në lajme, fillojnë të duken si personazhe të një drame teatrore.

Edhe pse kjo qasje mund të thjeshtojë një figurë komplekse, ajo ndihmon për të kuptuar motivet që e shtyjnë një njeri të veprorë. Në teatër apo në kinema, personazhet kanë role, tipare psikologjike dhe motive që i çojnë drejt zhvillimit të tyre. Në këtë film, versioni pjesërisht i trilluar i autoritarit nuk udhëhiqet nga dëshira për para, si oligarkët, por nga etja për pushtet. Ndërtimi i një imazhi force është pjesë e këtij qëllimi; propaganda është instrumenti që e bën të mundur.

Është një mënyrë e dobishme për të kuptuar liderët në mbarë botën. Baranovi shërben si figura ideale për këtë analizë, sepse ai e kupton nga afër sa lehtë mund të ndikohen dhe të formësohen mendjet e njerëzve.

Ky vështrim pas perdes është njëkohësisht forca më e madhe dhe elementi më i frikshëm i "Magjistarit të Kremlinit": ideja se, në një epokë ku e vërteta mund të prodhohet artificialisht, ata që e prodhojnë atë mbajnë në duart e tyre një pjesë të madhe të vetë realitetit. Por edhe ata mund të hidhen tutje sapo të mos jenë më të dobishëm për të pushtetshmit. Dhe atëherë lind pyetja e fundit: Për çfarë vlejti gjithë ajo magji? / bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Gjermania dhe Holanda eliminohen nga Kupa e Botës

NYU-JORK, 30 QERSHOR - Kupa e Botës 2026 ka prodhuar dy nga befasishtë më të mëdha të turneut, pasi Gjermania dhe Holanda janë eliminuar në fazën e 1/16-ave nga Paraguai, përkatësisht Maroku, pas ekzekutimit të penalltive. Gjermania është përballur me një sfidë të vështirë ndaj Paraguait, në një ndeshje të

mbyllur dhe me shumë tension. Pas 90 minutave dhe vazhdimeve, fituesi është përcaktua nga gjuajtjet e njëmbëdhjetëmetërsh, ku Paraguai është treguar më i saktë dhe ka siguruar një kualifikim historik në çerekfinale. Eliminimi i "Die Mannschaft" përbën një zhgënjim të madh për

katër herë kampionët e botës, të cilët e kanë mbyllur aventurën e tyre më herët sesa pritej. Edhe Holanda është eliminuar në një mënyrë dramatike, pasi Maroku ka triumfuar pas serisë së penalltive. "Luanët e Atlasit" kanë treguar qetësi në momentet vendimtare dhe siguruan një tjetër rezultat të madh në skenën

botërore. Me këto rezultate, Paraguai dhe Maroku kanë shkruar historinë duke kaluar në fazën tjetër të Botërorit, ndërsa dy prej përfaqësuesve më të njohura të futbollit evropian i japin lamtumirën turneut. Kupa e Botës 2026 po vazhdon të sjellë surpriza të mëdha, me skuadrat



më pak të favorizuara që po sfidojnë fuqitë tradicionale të futbollit botëror.

FFK-ja NIS HARTIMIN E STRATEGJISË SË RE TË ZHVILLIMIT, PAS REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE NË KOHË REKORD

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka nisur zyrtarisht procesin e hartimit të Strategjisë së re të zhvillimit, e cila do të përcaktojë drejtimin strategjik të futbollit kosovar nga viti 2027 e tutje. Në kuadër të këtij procesi, në Kosovë kanë qëndruar për vizitë ekspertët e UEFA-s, Oleksandr Kucheriavi, menaxher për Zhvillim Strategjik në Divizionin e Federatave Kombëtare dhe Ilija Kitiq, shef i Njesisë për Zhvillim Strategjik të Federatave Kombëtare. Ata kanë zhvilluar takime pune me presidentin e FFK-së, Agim Ademi dhe me koordinatoren për zhvillim të

projekteve në FFK, Doruntinë Fetahaj, duke nisur procesin e definimit të objektivave dhe prioriteteve të reja strategjike. Ky proces vjen si rezultat i suksesit të jashtëzakonshëm të Strategjisë "Themelet e së ardhmes" (2024-2028), e cila, ndonëse ishte planifikuar për një periudhë katërvjeçare, është zbatuar me sukses në pothuajse të gjitha pikat e saj brenda vetëm dy viteve. Gjatë takimeve, ekspertët e UEFA-s kanë shprehur vlerësimin dhe mirënjohjen e tyre për punën e bërë nga Federata e Futbollit e Kosovës, duke theksuar se përmbushja e pothuajse të gjitha



objektivave strategjike në një afat kaq të shkurtër përfaqëson një arritje të jashtëzakonshme. Sipas tyre, ky rezultat është dëshmi i vizionit të qartë, planifikimit strategjik dhe përkushtimit të vazhdueshëm të FFK-së në zhvillimin e futbollit në të gjitha nivelet.

Falë këtij progresi, FFK-ja tashmë ka krijuar bazën për një cikël të ri zhvillimor. Në bashkëpunim të ngushtë me UEFA-n, nga sot ka nisur puna për hartimin e strategjisë së re, e cila pritet të hyjë në fuqi gjatë vitit 2027 dhe do të përfshijë objektiva edhe më ambicioze për

zhvillimin e futbollit në Kosovë, në përputhje me standardet më të larta evropiane. Përmbushja e objektivave para afatit është dëshmi i qartë se me vizion, përkushtim dhe punë të vazhdueshme ndërtohen themelet e së ardhmes së futbollit të Kosovës. Strategjia e re do të ndërtohet mbi arritjet e deritanishme, duke vendosur objektiva të reja strategjike që do të mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm, rritje të standardeve dhe forcimin e mëtejshëm të pozitës së futbollit të Kosovës në arenën evropiane dhe ndërkombëtare, në fushë dhe jashtë saj.

PRESIDENTI DHE ZËVENDËSPRESIDENTI I DRENICËS JAPIN DORËHEQJE, KLUBI MBETET PA DREJTUESIT KRYESORË

SKENDERAJ, 30 QERSHOR - Presidenti i FC Drenicës, Thomas Wüstefeld, dhe zëvendëspresidenti i klubit, Faton Seferi, kanë dhënë dorëheqje nga pozitat e tyre me efekt të menjëhershëm. Wüstefeld ka njoftuar largimin përmes një mesazhi drejtuar familjes së klubit, tifozëve dhe qytetarëve të Drenicës, duke thënë se vendimi erdhi pas një reflektimi të gjatë. "Me keqardhje dhe pas një reflektimi të gjatë, jap dorëheqjen nga posti i presidentit me efekt të menjëhershëm", ka shkruar ai në letrën e tij.

Ai ka falënderuar të gjithë ata që, sipas tij, kanë dhënë gjithçka që klubi të mbetet në elitën e futbollit kosovar, duke e vlerësuar në mënyrë të veçantë angazhimin e Faton Seferit. "Përkushtimi yt i pandalshëm, angazhimi yt me pasion dhe gjithçka që ke bërë me gjithë zemër për këtë klub dhe për qytetin tonë, vështirë se mund të përshkruhet me fjalë", ka shkruar Wüstefeld. Edhe Faton Seferi ka bërë me dje largimin nga pozita e zëvendëspresidentit dhe tërheqjen nga marrëveshja e



synimit për privatizimin dhe zhvillimin e klubit. Në një reagim të gjatë, Seferi ka treguar se vendimi ishte rezultat i një viti me sakrificë, investime dhe përpjekje për ta stabilizuar

klubin. Ai ka treguar se kishte investuar mjete personale për shlyerjen e borxheve dhe financimin e klubit, ndërsa ka theksuar se procesi i privatizimit nuk u realizua sipas planit. Sipas tij, mungesa e investimeve të planifikuara nga partnerët dhe vonesat institucionale e kanë bërë të pamundur vazhdimin e projektit në formën e paraparë. Megjithatë, Seferi ka theksuar se nuk është larguar në një moment të vështirë për Drenicën, duke qëndruar pranë klubit deri në fund të sezonit. "FC Drenica

mbeti në Superligë. Sidomos pjesa e dytë e kampionatit ishte dëshmi se çfarë mund të arrijë një klub kur ka organizim, disiplinë dhe zemër", ka deklaruar ai. Seferi ka falënderuar futbollistët, trajnerët, tifozët, sponsorët dhe institucionet që e kanë mbështetur klubin, duke thënë se Drenica do të mbetet gjithmonë pjesë e jetës së tij. "Unë sot po largohem nga funksioni, por jo nga zemra e Drenicës. Drenica do të mbetet gjithmonë pjesë e jetës sime", ka përfunduar ai.

Ardian Krasniqi mbron titullin WBO: Ky është vetëm fillimi

MALLORCA, 30 QERSHOR - Boksieri shqiptar Ardian Krasniqi ka vazhduar formën e tij të jashtëzakonshme, duke mbrojtur me sukses titullin WBO Intercontinental dhe duke u shpallur kampion evropian, pas fitores ndaj kroatit Vinko Zadro në një meç të zhvilluar deri në 12 raunde. Me këtë triumf, Krasniqi e ka

çuar bilancin e tij perfekt në ring në 13 fitore në po aq meçe, duke mbetur i pamposhtur në karrierën profesioniste. Pas përfundimit të duelit, ai ka reaguar me një mesazh emocional, duke e cilësuar këtë sukses si një nga momentet më të veçanta të karrierës së tij dhe duke ia dedikuar fitoren tifozëve shqiptarë, familjes dhe

të gjithë mbështetësve të tij. "U shpalla kampion Evrope dhe mbrojta me sukses titullin tim WBO Intercontinental. Faleminderit nga zemra të gjithë tifozëve që më dhatë forcë dhe besuat tek unë. Një falënderim i veçantë për familjen time, sidomos për babain tim, Agimin, i cili sakrifkoi gjithçka që unë të

jem sot këtu ku jam. Ky sukses mban edhe emrin e tij. Faleminderit xhaxhait tim, Luanit, sepse gjithçka filloi prej tij. Ai është arsyeja pse hyra në këtë rrugëtim dhe pse sot jetoj këtë ëndërr. Faleminderit trajnerëve të mi, vëllezërve të mi dhe gjithë stafit për besimin dhe mbështetjen e palëkundur. Ky është vetëm fillimi. Rruga



drejt titullit të Kampionit të Botës tani është e hapur", ka shkruar Krasniqi në rrjetet sociale.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



